VENDIM
Nr. 297, datë 10.4.2013

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 17, DATË 21.1.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRDORIMIN DHE KONTROLLIN E FONDEVE PUBLIKE PËR VEPRIMTARI SPECIFIKE, OPERATIVE, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 10 të ligjit nr. 8391, datë 28.10.1998 "Për Shërbimin Informativ të Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas shkronjës "d" të pikës 1 të vendimit nr. 17, datë 21.1.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje:

"e) krijimin dhe administrimin e pasurive dhe të aktiviteteve ekonomike në funksion të realizimit të detyrave. Të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurive dhe aktiviteteve ekonomike me qëllim kamuflimi do të përdoren sipas kësaj pike të vendimit.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha